

URDHËR

Nr. 4895 / , datë 01 / 11 / 2016

PËR

**MIRATIMIN E FORMATEVE TË LISTAVE TIP TË DOKUMENTEVE GJYQËSORE QË
ARKIVOHEN NGA GJYKATAT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", si dhe pikës 8 të VKM nr. 903, datë 17.12.2014, "Për krijimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor", me propozim të Drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formateve të listave tip të dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat, sipas Anekseve bashkëlidhur dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

2. Lista tip përcakton afatet e ruajtjes së dokumenteve dosjeve, regjistrave dhe dokumenteve gjyqësore që arkivohen nga gjykatat, të kategorizuara si më poshtë:

- Aneksi 1 – Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve civile
- Aneksi 2 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve penale
- Aneksi 3 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve administrative
- Aneksi 4 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të çështjeve tregtare
- Aneksi 5 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të gjykatave të apelit të depozituara në gjykatat e shkallës së parë
- Aneksi 6 - Lista tip e dosjeve gjyqësore të menaxhimit të çështjeve